



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK / OPŠTINA JUNIK	MUNICIPALITY OF JUNIK
QZ/NO. FIDR	2-060/11535
Nr./Dat.	13/12 2023



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës së Junikut;
Komiteti për Politikë dhe Financa;
Numër: 02-12/23;
Datë: 13.12.2023.

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa iu bënë këtë:

FTESË

Për: anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa;
Nga: Shpejtim Gacaferi - kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa;
Lënda: mbledhja e dymbëdhjetë (12) (2023) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa;
Vendi: salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 22.12.2023, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit dhe orari i mbajtjes së takimeve të rregullta të Kuvendit Komunal për vitin 2024 / leximi dytë/;
4. Pyetje nga anëtarët e KPF-së;
5. Të ndryshme.



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

KOMITETI PER POLITIKË DHE FINANCA

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 02-11-23

Datë: 22. 11. 2023, ora 10⁰⁰

PROCESVERBAL

i

Mbledhjes së Njëmbëdhjetë të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa në Junik, të mbajtur me datë 22 Nëntor, 2023, në orën 10⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Komiteti si në vijim:

1. Shpejtim Gacaferi, kryesues (LDK),
2. Xhemë Tofaj, përfaqësues (LVV),
3. Ermelinda Lolluni, përfaqësuese (LDK),
4. Rajmonda Krasniqi, përfaqësuese (AAK), dhe
5. Dervish Bajraktari, përfaqësues (AAK),

Poashtu, të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i Komunës z. Ruzhdi Shehu, nënkryetari z. Besart Tofaj, drejtoresha për Buxhet dhe Financa znjsh. Vjollca Qestaj, zyrtari i lartë financiar z. Arten Hamza, drejtori për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis z. Zenun Shala, drejtoresha për Administratë të Përgjithshme znjsh. Leonora Shehu, dhe zyrtarja e Tatimit në Pronë znj. Saranda Isufaj.

Mbledhjen e Njëmbëdhjetë të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa e shpalli të hapur kryesuesi i këtij Komiteti, z. Shpejtim Gacaferi, i cili ceku se të pranishëm në këtë mbledhje janë të gjithë anëtarët e KPF-së.

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi paraqiti dhe kërkoi miratimin e Rendit të Ditës, si në vijim;

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit dhe orari i mbajtjes së takimeve të rregullta të Kuvendit Komunal për vitin 2024, (leximi i parë),
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Grupin e Grave të Kuvendit Komunal të Junikut 2023-2025,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2024 (leximi i dytë),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Normave Tatimore për vitin 2024,
7. Informatë lidhur me zbatimin e rregulloreve dhe dokumenteve strategjike komunale,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i listës së përgjithshme dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme që planifikohen për dhënie në shfrytëzim.

9. Pyetje nga anëtarët e KPF-së, dhe
10. Të ndryshme.

Ky Rend i Ditës me pesë vota për, asnjë kundër, dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e KPF-së.

Pika e Parë **Arsyetimi i mungesave në mbledhje**

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi tha, të gjithë anëtarët e KPF-së janë të pranishëm në këtë mbledhje!

Pika e Dytë **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Ky procesverbal u shqyrtua, dhe me pesë vota për, asnjë kundër, dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e KPF-së.

Pika e Tretë **Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit dhe orari i mbajtjes së takimeve të rregullta të Kuvendit Komunal për vitin 2024, (leximi i parë)**

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi tha, Kuvendi ka nxjerrë vendim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024, në këtë përbërje; Shpejtim Gacaferi, Mursel Salihaj, Zenel Maloku, Eliza Pepshi, dhe Leonora Shehu.

Ne kemi përgatit Planin e Punës për vitin 2024 dhe tani jemi në leximin e parë, i cili ka disa përmirësime të vogla të draftit.

Z. Dervish Bajraktari tha, unë po e shoh që në muajin Gusht nuk do të mbahet mbledhja e Kuvendit, dhe unë kërkoj që mbledhja e Kuvendit të mbahet edhe në muajin Gusht, siç është mbajtur deri më tani.

Z. Shpejtim Gacaferi tha, ne si grup punues e kemi paraparë që muaji Gusht të jetë pushim për të vetmen arsye sepse prej shumë komunave vetëm Juniku mban mbledhje në muajt Korrik dhe Gusht, sepse këta janë muajt të pushimeve verore, dhe se gjatë këtyre dy muajve mungojnë shumica e drejtorëve. Prandaj, unë iu ftoj që me këtë propozim ky plan i punës së Kuvendit të votohet këtu në KPF dhe pastaj të shikoj për votim edhe Kuvend, ndërsa në muajin Dhjetor do të kemi edhe leximin e dytë.

Me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga KPF-ja Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2024, në lexim të parë.

Pika e Katërt **Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Grupin e Grave të Kuvendit Komunal të Junikut 2023-2025**

Në mungesë të kryesueses të Grupit të Grave të Kuvendit Komunal të Junikut znjsh. Eliza Pepshi, kjo pikë e Rendit të Ditës, me pesë vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim kalon për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal.

Pika e Pestë **Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullore për Taksa, Ngarkesa dhe Gjeba Komunale për vitin 2024 (leximi i dytë)**

Drejtoresha znjsh. Vjollca Qestaj tha, kjo Rregullore është në fazën e leximit të dytë, e cila ka kaluar në procedurë të rregullt në leximin e parë. Grupi Punues është marrë me këtë Rregullore deri në muajin Qershor

të këtij viti që është në përdorim për vitin 2023, ndërsa për vitin 2024 nuk kemi ndryshime të mëdha nga rregulloja aktuale, përpos atyre dy ndryshimeve të vogla që janë prezantuar në leximin e parë, pra, riformulimi i dy fjalive. Si Rregullore ka kaluar edhe në diskutimin publik që ka përfunduar me datë 16 Nëntor, dhe tani duhet që me procedurë të rregullt të kaloj edhe leximin e dytë që kërkon miratimin e KPF-së dhe të Kuvendit, dhe si e tillë me këto norma tatimore për vitin 2024.

Kjo Projekt-Rregullore u hodh e votim, dhe me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga KPF-ja.

Pika e Gjashtë

Shqyrtimi dhe miratimi i Normave Tatimore për vitin 2024

Znjsh. Vjollca Qestaj tha, bashkë me kërkesën e drejtorisë për shqyrtimin e normave tatimore ju e keni marrë raportin mbi ndryshim-plotësimet e normave tatimore nga Grupi Punës për ndryshimet në këtë rregullore, duke u bazuar në ligjin mbi Pronën e Paluajtshme që u japë të drejtën komunave që të bëjnë ndryshimet e normave tatimore për 3-5 vite.

Në raport janë të prezantuara ndryshimet e këtyre normave tatimore, ku ky ndryshim sipas ligjit mund të variojnë nga .10 deri në 1 %, pra vetëm brenda këtij niveli Komuna mund t'i ndryshoj normat tatimore. Gjithashtu në bazë të ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme dhe ndryshimeve që kanë ndodhë në këtë ligj, ku nga zbritja primare ka përfituar secili tatimpagues.

Në bazë të këtij ligji është bërë edhe ulja e vlerave të koeficientëve për çdo njësi apo objekt banimi, p.sh. nga vlera 1.1 është bërë zbritja në 1% për objektet në gjendje të shkëlqyer apo shumë të mirë, për objektet në gjendje të mirë nga 1% në 0.9 %, për objektet e banimit në gjendje mesatare nga 0.8 në 0.7 %, për ato në gjendje të keqe nga 0.6 në 0.4%, dhe për objektet e pabanuara nga 0.5 në 0.2%.

Gjithashtu Grupi Punës ka punuar edhe me norma tatimore që janë të prezantuara në raport, dhe e dini që të hyrat nga tatimi në pronë janë të hyrat kryesore për secilën Komunë, pra, këto janë propozimet për vitin 2024, dhe që kjo normë të jetë 0.10%.

Ndërsa, normat tatimore për pronë bujqësore-parcelë është 0.10%, pronë bujqësore apo objekt 0.10%, pronë rezidenciale-parcelë 0.10%, pronë rezidenciale-objekt 0.15%, zona komerciale-objekt 0.15%, pronë rezidenciale-parcelë 0.10%, pronë industriale-objekt 0.15%, dhe pronë industriale-parcelë 0.15%.

Grupi Punës ka shkuar me minimalen normave tatimore, d.m.th., kemi zbritje të normave tatimore.

Znj. Rajmonda Krasniqi pyeti nëse këto zbritje janë në nivel të Kosovës?

Znjsh. Vjollca Qestaj tha, këto janë vetëm për Komunën e Junikut.

Me pesë vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim nga KPF-ja u miratuan normat tatimore për vitin 2024 në Komunën e Junikut.

Pika e Shtatë

Informatë lidhur me zbatimin e rregulloreve dhe dokumenteve strategjike komunale

Drejtoresha znjsh. Leonora Shehu tha, në bazë të Planit të Punës për vitin 2023, në Dhjetor është paraparë që si pikë e Rendit të Ditës nga Drejtoria e Administratës që t'iu informon në lidhje me zbatimin e rregulloreve komunale të dokumenteve strategjike komunale, ndërsa iu informojmë që të gjitha këto rregullore janë duke u zbatuar. Disa nga këto rregullore që janë në fuqi janë duke u zbatuar, por që së fundmi janë miratuar disa plotësim-ndryshime në përputhshmëri me ligjet në fuqi.

Në Dhjetor të vitit 2022 është miratuar plotësim-ndryshimi i Rregullores për Këshillat Lokale, e cila është në fuqi dhe në pajtueshmëri me këto ndryshime është bërë edhe zgjedhja e Këshillave Lokale.

Është miratuar Plani Emergjent dhe Reagimi i Komiteteve të Kuvendit Komunal.

Në muajin Shkurt 2023 është miratuar Plani i Veprimit për Transparencë për periudhën 2023-2026.

Në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale në harmoni me strategjinë për migrim, Rregullorja për Integrimin e Personave të Riatdhesuar, duke u bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve është miratuar Plani Komunal për Ri-integrimin e Qëndrueshëm për Personat e Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Junikut për 2023-2025.

Duke u bazuar në ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, ligjin për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës dhe ligjin për Kundërvajtje, është miratuar plotësim-ndryshimi i Rregullores për Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Junikut.

Duke u bazuar në ligjin për Vetëqeverisje Lokale, ligjin për Financa dhe Pushtetin Lokal dhe Rregullores së Punës së Kuvendit është bërë plotësim-ndryshimi i Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale. Në bazë të ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Udhëzimin Administrative për Metodologjinë e Vlerësimit të Pronës së Paluajtshme, dhe ligjit për Vetëqeverisje Lokale është bërë plotësim-ndryshimi i Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Në bazë të ligjit për Shëndetësi, Kuvendi Komunal ka miratuar edhe Statutin e QKMF-së, i cili është në zbatim. Dhe, rregullore tjetër që është miratua është edhe Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut.

Pika e Tetë

Shqyrtimi dhe miratimi i listës së përgjithshme dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme që planifikohen për dhënie në shfrytëzim

Drejtori z. Zenun Shala tha, meqenëse Ministria e Pushtetit Lokal na ka dërguar kërkesë që të bëhet rifreskimi i listës së pronave deri me datën 31 Dhjetor, ne kemi marrë një vendim bazuar në përgjegjësitë në bazë të ligjeve në fuqi, për publikimin e listës së pronës së paluajtshme të Komunës, dhe Rregullores së Kuvendit të Komunës së Junikut t’iu parashtrojmë këtë Kërkesë që të miratohet në Kuvendin e Komunës së Junikut lista e përgjithshme dhe e veçantë e pronave të paluajtshme që planifikohet për dhënie në shfrytëzim.

Z. Zenun Shala për anëtarët e KPF-së paraqiti këtë listë, e cila me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga KPF-ja.

Pika e Nëntë

Pyetje nga anëtarët e KPF-së

Znj. Rajmonda Krasniqi pyeti kryetarin se kur planifikohet fillimi i mësimin në objektin e shkollës se re fillore në Junik?

Kryetari z. Ruzhdi Shehu tha, ju e dini se ky është investim nga Ministria, dhe marrëdhënia mbikëqyrëse është e Ministrisë, por që ka bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit dhe janë shkëmbyer shkresa që mësimi të filloj sa më shpejtë, por për shkak të moskryerjeve të punimeve akoma nuk është bërë pranimi teknik nga ana e një komisioni nga Ministra e Arsimit. Megjithatë, ata kanë dërguar një shkresë që shkolla mund të shfrytëzohet, por ne kemi kërkuar edhe një konfirmim zyrtar për këtë, por kjo duhet të miratohet nga Ministria.

Pika e Dhjetë

Të ndryshme

Z. Dervish Bajraktari tha, unë kam kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, por drejtori nuk është i pranishëm. Kjo është në lidhje me “policët e shtrirë” në lagjen Bajraktar, ku shpejtësia e automjeteve në atë rrugë është tepër e madhe, dhe rrezikon fëmijët dhe qytetarët në përgjithësi. Aty para disa ditëve kemi pasë një aksident, dhe kërkoj që këto pengesa të vendosen nga Komuna ose ato do t’i vendosin ne.

Poashtu, kërkoj që të hyrja e lagjes Bajraktar dhe të Knusht të vendoset një pasqyrë, sepse aty në të dy anët e rrugës janë muret dhe rruga kryesore nuk shihet, dhe pikërisht aty ka ndodhur edhe aksidenti. Prandaj, kërkoj nga ju që të ndërmerrini masa për këto dy kërkesa, përndryshe ne do të detyrohemi që t'i vendosim ato privatisht.

Z. Ruzhdi Shehu tha, këto janë kërkesa me arsye, por akoma nuk e kemi një kontratë dhe paramasën. Kryesisht këto kërkesa nuk janë të mira sepse pengojnë qarkullimin, por policia duhet të ketë një kujdes të shtuar në atë rrugë, si dhe në rrugën Berishë, të tyrbja. Por, duhet të bëhen paramasat dhe kjo të kryhet menjëherë.

Z. Besart Tofaj tha, KKSB dhe KLSP kanë fituar një donacion nga OSBE, që përfshinë rreth 30 pasqyra, dhe aty do të vendosim një pasqyrë sa më shpejtë që është e mundur.

Z. Xhemë Tofaj ceku se me ndërtimin e murit mbrojtës i ndërtuar rishtas në lagjen Tofaj nuk është lënë hapësirë për ecje të këmbësorëve. Ai tha se punimi është bërë i mirë, mirëpo rruga është ngushtuar shumë, ndërsa rreth një metër ka mbetur hapësirë e humbur.

Z. Dervish Bajraktari pyeti kryetarin se kur do të shpërndahen bursat për studentë të cilët kanë aplikuar, të cilët po pyesin se kur do të shpërndahen këto bursa?

Z. Ruzhdi Shehu tha, bursat e ndarë që nuk janë dhënë hiç për vitin 2021, ne i kemi paguar në vitin 2022, ndërsa për bursat e ri jemi në proces të vlerësimit. Kriteret janë të vendosura dhe besoj që së shpejti do të shpërndahen edhe këto bursa.

Me kaq, kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi e shpalli të mbyllur mbledhje e dhjetë të KPF-së.

Gëzim Geci-Procesmbajtës

Shpejtim Gacaferi-Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK-OPSTINA JUNIK-MUNICIPALITY JUNIK



Numër : 02/180/

Data : 00.00.0000

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL NË JUNIK PËR VITIN 2024

Hyrje:

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale (neni 35 paragrafi 35.1 i LVL-së).

Kuvendi i Komunës së Junikut ka për obligim të zbatojë rolin e tij legjislativ dhe drejtues në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet e tjera të Republikës së Kosovës.

Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2024 është dokument orientues i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2024 duke paraqitur veprime konkrete të planifikuara, me qëllim të përmbushjes së detyrave të tij në fushën e legjislacionit dhe të mbikëqyrjes si dhe të ngritë transparencën dhe llogaridhënien para qytetarëve junikas.

Ky plan mund të pësoj ndryshime varësisht prej nevojave që paraqiten me kalimin e kohës.

Objektivat

a) Si organi më i lartë, Kuvendi i Komunës së Junikut ka për objektiv krijimin e kornizës ligjore që definojnë parametrat brenda së cilës:

1. do të funksionojë administrata (ekzekutivi),
2. do të mbikëqyrë dhe monitorojë aktivitetet e administratës (ekzekutivit) për t'u siguruar se ato janë në përputhje me kornizën ligjore,
3. në bashkëpunim me administratën (ekzekutivin), të vendosë drejtimin strategjik për zhvillimin ekonomik, fizik dhe financiar të Komunës së Junikut, dhe
4. siguron që parimet e një shoqërie demokratike janë të qëndrueshme në mënyrën me të cilën realizon rolin e tij legjislativ dhe drejtues.

Qëllimi

b) Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut shërben si mjet për të arritur qëllimet e mëposhtme përmes planifikimit të plotë dhe të kujdesshëm.

Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2023:

1. siguron që Kuvendi i Komunës së Junikut po i përmbush obligimet ligjore duke i miratuar të gjitha rregulloret që i parasheh ligji dhe që janë të nevojshme për shfrytëzim efektiv të resurseve të Komunës së Junikut,
2. shërben si një instrument me anë të të cilit Kuvendi i Komunës së Junikut mund të mbikëqyrë punën e administratës (ekzekutivit) përmes dorëzimit të raporteve financiare dhe të performancës,
3. funksionon si mjet që shton gjasat për arritjen e objektivave të Komunës së Junikut përmes ndërtimit të një kornize ligjore të qëndrueshme,
4. ngrit efikasitetin e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe të administratës (ekzekutivit) në përgjithësi, dhe
5. ngrit transparencën e Kuvendit të Komunës së Junikut. (Qytetarët janë të informuar për aktivitetet e planifikuara paraprakisht dhe kështu mund të jenë më të frytshëm në punën e Kuvendit të Komunës së Junikut, në veçanti duke dhënë kontribut në vendimet që kanë rrjedhoja afatgjata dhe të rëndësishme financiare, ekonomike dhe sociale në Komunën e Junikut.)

<u>Muaj</u>	<i>Aktivitetet e Kuvendit</i>	<i>Data</i>	<i>Aktivitetet e Komitetit për Politikë dhe Financa</i>	<i>Data</i>	<i>Aktivitetet e Komitetit për Komunitete</i>	<i>Data</i>
Janar	1. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katert, tetor-dhjetor 2024; 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës i	31.01.2024	1. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katert, tetor-dhjetor 2024; 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës i komitetit për Komunitete për vitin 2024,	23.01.2024		

	komitetit për Komunitete për vitin 2024, 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës i komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2024, 4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2023; 5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2023; 6. Raporti i punës së KKSB-së për vitin 2023; 7. Shqyrtimi i Raportit të punës së prokurimit për vitin 2023;		3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës i komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2024, 4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2023; 5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2023; 6. Raporti i punës së KKSB-së për vitin 2023; 7. Shqyrtimi i Raportit të punës së prokurimit për vitin 2023;			
Shkurt	Seancë solemne me rastin e ditës së pavarësisë së Republikës së Kosovës (17 shkurt); 1. Raporti i buxhetit për vitin 2023;	17.02.2024 29.02.2024	Seancë solemne me rastin e ditës së pavarësisë së Republikës së Kosovës (17 shkurt); 1. Raporti i buxhetit për vitin 2023; 2. Informatë rreth mirembajtjes / pastrimit nga bora	17.02.2024 21.02.2024		

	2. Informatë rreth mirembajtjes / pastrimit nga bora / te rrugeve lokale në zezonin e dimrit;		/ te rrugeve lokale në zezonin e dimrit;			
Mars	1. Shqyrtimi dhe miratimi I raportit financiar për vitin fiskal 2023; 2. Shqyrtimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2023 në vitin 2024, 3. Njoftim mbi shfrytezimin e pronave Komunale;	29.03.2024	1. Shqyrtimi dhe miratimi I raportit financiar për vitin fiskal 2023; 2. Shqyrtimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2023 në vitin 2024, 3. Njoftim mbi shfrytezimin e pronave Komunale;	20.03.2024		
Prill	1. Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën e pare janar-mars 2024; 2. Informatë lidhur me gjendjen e shërbimeve	30.04.2024	1. Shqyrtimi I raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën e pare janar-mars 2024; 2. Informatë lidhur me gjendjen e shërbimeve publike në komunën e Junikut;	22.04.2024		

	publike në komunën e Junikut; 3. Informatë lidhur me gjendjen e arsimit në komunën e Junikut; 4. Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024; 5. Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa;		3. Informatë lidhur me gjendjen e arsimit në komunën e Junikut; 4. Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023; 5. Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa;			
Maj	1. Informatë mbi zhvillimin e sektorit të turizmit në komunën e Junikut;	31.05.2024	1. Informatë mbi zhvillimin e sektorit të turizmit në komunën e Junikut; 2. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore	21.05.2024		

	2. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore 2025/27 të Ministrisë së Financave;		2025/27 të Ministrisë së Financave;			
Qershor	Seancë solemne me rastin e Ditës së Çlirimit të komunës së Junikut (13 qershor);	13.06.2024				
	1. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027; 2. Rishikimi i buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2024;	28.06.2024	1. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027; 2. Rishikimi i buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2024;	20.06.2024		
Korrik	1. Shqyrtimi i raportit financiar per periudhen e dytë janar-qershor 2024; 2. Njoftim me raportin e punës së Kryetarit te komunës për 6 mujor te vitit 2024;	31.07.2024	1. Shqyrtimi i raportit financiar per periudhen e dytë janar-qershor 2024; 2. Njoftim me raportin e punës së Kryetarit te komunës për 6 mujor te vitit 2024; 4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim Vendimit për taksat komunale të ndërtimit për vitin 2024;	23.07.2024		

	4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim Vendimit për taksat komunale të ndërtimit për vitin 2024; 5. Informatë mbi raportin e performancës së administratës së komunës së Junikut për vitin 2024; 6. Shqyrtimi I Raportit dhe analiza e viti shkollor2023/2024; 7. Njoftim mbi raportin e performances për vitin 2023;		5. Informatë mbi raportin e performancës së administratës së komunës së Junikut për vitin 2023; 6. Shqyrtimi I Raportit dhe analiza e viti shkollor2023/2024; 7. Njoftim mbi raportin e performances për vitin 2023;			
Gusht	1. Informatë rreth pergaditjeve per fillimin e vitit te ri shkollor 2024/2025; 2. Informatë rreth korrje – shirjeve te grurit ne komunen e Junikut.	30.08.2024	<u>1.</u> Informatë rreth pergaditjeve per fillimin e vitit te ri shkollor 2024/2025; 2. Informatë rreth korrje – shirjeve te grurit ne komunen e Junikut.	30.08.2024		

Shtator	Dëgjimi publik i Draft Buxhetit Komunal për vitin 2024-2027		Dëgjimi publik i Draft Buxhetit Komunal për vitin 2024-2027			
	1. Shqyrtimim dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2024-2027; 2. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Junikut për vitin 2023 nga Zyra e Auditorit Kombëtar; 3. Formimi i Grupit të punës për hartimin e projekt Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2025; 4. Shpallja në diskutim public e Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025; 5. Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa për vitin 2025;	27.09.2024	1. Shqyrtimim dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2024-2027; 2. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Junikut për vitin 2023 nga Zyra e Auditorit Kombëtar; 3. Formimi i Grupit të punës për hartimin e projekt Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2025; 4. Shpallja në diskutim public e Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025; 5. Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa për vitin 2025;	20.09.2024		

Tetor	1. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën e tretë janar-shtator 2024; 2. Informatë mbi gjendjen e shëndetit publik në komunën e Junikut; 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për Eficiencë dhe Klimë për K. Junikut;	31.10.2024	1. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën korrik-shtator 2024; 2. Informatë mbi gjendjen e shëndetit publik në komunën e Junikut; 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për Eficiencë dhe Klimë për K. Junikut;	23.10.2024		
Nëntor	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025; 2. Informatë lidhur me zbatimin e rregulloreve komunale dhe dokumenteve strategjike komunale.	26.11.2024	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025; 2. Informatë lidhur me zbatimin e rregulloreve komunale dhe dokumenteve strategjike komunale.	20.11.2024		
Dhjetor	1. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Planit të punës së Kuvendit për vitin 2025; 2. Njoftimi me Planin vjetor të punës së Zyres së Prokurimit; 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Project	30.12.2024	1. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Planit të punës së Kuvendit për vitin 2025; 2. Njoftimi me Planin vjetor të punës së Zyres së Prokurimit ; 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Project Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2025;	23.12.2024		

	Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale;		4. Shqyrtimi dhe miratimi I Projekt Rregullores per tatimin ne pronen e paluajtshme për vitin 2025;			
--	---	--	---	--	--	--

Sqarim:

Grupi punues për hartimin e Planit vjetor për punën e Kuvendit Komunal me kujdes dhe përgjegjësi ka shqyrtuar te gjitha ligjet dhe aktet tjera nënligjore të nivelit qendror e të cilat kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe kompetencat ligjore të Kuvendit Komunal dhe kryetarit të Komunës dhe me perpikëri dhe perkushtim më të madh I ka perfshirë në këtë plan si aktivitete me qellim që Kuvendi të jetë sa më funksional dhe përgjegjës në realizimin e kërkesave të qytetarëve, anëtarëve të Kuvendit, KPF-së, KK, dhe të kërkesave dhe përgjegjësi të kryetarit të Komunës. Mirëpo, sigurisht që dinamika e këtij plani gjatë zbatimit mund të pësoj ndryshime dhe plotësime sipas nevojës dhe paraqitjes së kërkesave të arsyeshme qoftë nga ana e qytetarëve, delegatëve të Kuvendit dhe kryetarit të Komunës apo edhe përgjegjësi të tjera që dalin nga miratimi I ligjeve të reja dhe aktiviteteve tjera nënligjore.

Anëtarët e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024:

1. Shpejtim Gacaferi, Kryesues i Kuvendit Komunal;
2. Mursel Salihaj, anëtar I Kuvendit nga LDK;
3. Zenel Maloku, anëtar I Kuvendit nga AAK;
4. Eliza Pepshi, anëtare e Kuvendit nga LVV;
5. Leonora Shehu, Drejtoreshë e Administratës

- Afatet për përmbushjen dhe realizimin e aktiviteteve të parapara:

Realizimi i aktiviteteve të parapara me planin e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut do të bëhet brenda dymbëdhjetë muajve të vitit 2024.

- Kostoja financiare për zbatimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2024 është: 138,812.00 €
- Paga dhe meditje gjithsejtë të parapara janë: 134,812.00 €
- Ndersa për mallra dhe sherbime të parapara janë: 4,000.00 €

Kuvendi i Komunës së Junikut

z. Shpejtim Gacaferi

kryesues